



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

Nr. 006/16
Datë: 06.10.2016

Bazuar në nenin 9 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit për Trashëgimi Kulturorë, nenin 4.1 të Rregullores 01/2016 për Punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, nenet 2.18, 2.19 të Rregullores 02/2016 për Vlerësimin dhe Shpalljen e Trashëgimisë Kulturorë në Mbrojtje të Përhershme, nenet 4.4, 4.5 dhe 4.6 të Rregullores 05/2005 mbi Regjistrimin, Dokumentimin, Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Trashëgimisë Kulturorë për Mbrojtje, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, pasi shqyrtoi propozimin e asetit të trashëgimisë kulturore “**Kështjella Antike e Keqekollës**” nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në mbledhjen e datës 06.10.2016, merr:

V E N D I M

1. S H P A L L në mbrojtje të përhershme asetin e trashëgimisë kulturore arkeologjike “**Kështjella Antike e Keqekollës**” me numër unik TKRKS2A006, bazuar në kriteret dhe vlerat arkeologjike, artistike dhe shkencore.
2. “**Kështjella Antike e Keqekollës**” shtrihet në fshatin Keqekollë, Komuna e Prishtinës, zona kadastrale Prishtinë, me perimetër 5.30 Ha dhe zonë rrethuese 53.25 Ha, sipas hartës së bashkangjitur me koordinata gjeografike, përbën asetin e shpallur në kuadër të kategorisë trashëgimi arkeologjike.
3. MKRS obligohet që të përfshijë në listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme asetin e shpallur me këtë vendim.
4. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që brenda afatit gjashtë (6) muajsh të hartojë planin e administrimit – menaxhimit për asetin e lartcekur.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetar i KKTK
Shafi Gashi



Ky vendim i dërgohet:

- Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Arkivit të KKTK